REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:104456

Datë: 29.08.2019

Numri i dokumentit: 00482372

C.nr.152/18

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Mirvete Alidemi, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike të paditëses: .... , kundër të paditurit F.K. nga .... , me objekt kontesti kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 162,93 €, jashtë seancës më datën 26 Gusht 2019 mori këtë:

A K T GJ Y K I M
PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES/

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit .... nga .... , dhe **DETYROHET** i padituri F.K. , që paditëses t'i paguaj dëmin e shkaktuar material në shumen prej 162.93 €(një qindë e gjashtëdhjetë e dy euro e nëntëdhjetë e tre cent), me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar ditës së paraqitjes së padisë e deri në ditën e pagesës përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditës, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET i padituri që paditëses ti pagauj shpenzimet gjyqësore në emër të tarifës gjyëqsore në shumë prej 20 €.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë më datën 08 Shkurt të vitit 2018, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kompensimin e dëmit material në shumë prej 162.93 € me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe ka kërkaur shpenzimet e proceduës gjyëqsore, në afat prej 15 ditësht, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nënë kërcënimin e përmbrimit të dhunshëm].

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin C.nr.152/2018 të dt.06 Mars 2018, të cilin i padituri e ka pranuar më dt. 16 Mars 2018 (e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë i njëjti nëse nuk paraqet përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tij.

2019:104457

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar personalisht aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK-së, në të cilën dispozitë shprehimisht parashihet se *"Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të padituri i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht."*

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë e ka vërtetuar faktin se i padituri prej datës së pavërtetuar e deri ë datën 12.03.2014 në shtëpinë e tij me qëllim që ti sjell vetit pasuri të kundërligjshme, pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike në atë mëryer që njehsori elektrik ka qenë pa bllomba, në afërsi kishte të vendosur në ndërruesin 0,1,2, një lidhje para njehsorit dhe ka dërguar një ndërprerës i cili ndërprerës ishte kthyer në pozitën dy e që energjia e harxhuar nuk ka kaluar ndërmjet njehsorit ashtu që energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar e me këtë veprim i padituri i ka shkaktuar paditëses së dëmin në vlerë prej 162.93 €.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 150 i LPK-së, e në lidhje me dispozitat nga neni 262, par. 1 i LMD-së i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-077, ku përcaktohet se "Kreditori në mardhëniet detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë prë/mbushjen e detyrimit, kurse debitori është i deteyruar që ta përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi siq kanë parapr më pare", gjeti sed kërkesëpadia e paditeses është bazuar dhe vendsoi si në dispozitiv të këtij aktgyjkimi.
Gjykata vendosi për kamatë ligjore prej 8% duke u mbështetur në dispozitën e nenit 282 të LMD/ Nr. 04/L-077/ i vitit 2012.
Vendimi që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën ligjore në mbështetje të nenit 449 dhe 452 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet tarifës për padi në shumë prej 15 € .
Duke u bazuar në të dhënat e lartshenuara gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.152/18, më datën 26 Gusht 2019

Gjyqtarja,
Mirvete Alidemi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.